



# BULETINI I PROKURORISË THEMELORE NË GJILAN

Korrik - Shtator 2024



*Përmes këtij buletini do të pasqyrohen aktivitetet kryesore, të cilat janë realizuar në Prokurorinë Themelore në Gjiçan, për periudhën kohore Korrik - Shtator 2024.*

## **Ndalohet një person për keqpërdorim të besimit**

**Gjilan, 02 korrik 2024**

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti Përgjithshëm, ka ndaluar të dyshuarin B.K., në kohëzgjatje prej 48 orëve, për shkak të dyshimit se ka kryer veprën penale “Keqpërdorimi i besimit”, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Dyshohet se i njëjti, me qëllim të përfitimit material ka keqpërdorur besimin tek e dëmtuara L.G., në atë mënyrë që nga ajo kishte marrë autorizim që të vepronte në emër të saj, në mënyrë që t’ia siguronte mjetet financiare të babait të saj, si ish i burgosur politik në burgjet e Jugosllavisë, ku për këtë shërbim kishte kërkuar 20% nga shuma totale e kompensimit.

I dyshuari B.K., dyshohet se në vitin 2023 ka arritur ti nxjerrë këto mjete financiare nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ku shuma rreth 24 mijë euro ishte depozituar në llogarinë e tij, mirëpo i njëjti për këtë nuk e kishte informuar të dëmtuarën, edhe pse njëjta vazhdimisht ishte interesuar.

Me këto veprime dyshohet të ketë kryer veprën e sipërshënuar penale dhe ndaj tij brenda afatit ligjor Prokuroria Themelore në Gjilan, do të vendosë lidhur me masën për sigurinë e të pandehurit në procedurë penale.

---

## **Kryeprokurori Kadriu priti në takim Kryesuesin Hajdaraj**

**Gjilan, 16 korrik 2024**

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan, z. Arben Kadriu ka pritur në takim Kryesuesin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Ardian Hajdaraj, Anëtarët e Këshillit Prokurorial të Kosovës z. Armend Zenelaj dhe z. Jetish Maloku, si dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Sami Istrefi.

Gjatë këtij takimi morën pjesë edhe prokurorë nga Departamenti i Krimeve të Rënda dhe administratori i kësaj prokurorie.

Kryeprokurori Kadriu fillimisht njoftoi të pranishmit sa i përket mbarëvajtjes së punëve dhe sfidat me të cilat ballafaqohen në hetimin dhe ndjekjen e veprave penale, në kompetencë të kësaj prokurorie, me ç’rast theksoi edhe raportet e punës për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2024.

Po ashtu u prezantuan edhe raportet e punës për këtë gjashtëmuajor sa i përket veprave penale të dhunës në familje, ku nga Kryesuesi Hajdaraj u kërkuar që këto raste të trajtohen me prioritet.

Gjithashtu, u diskutua edhe çështja e pjesëmarrjes nëpër trajnime profesionale për prokurorët dhe në përgjithësi nevojat konkrete të kësaj prokurorie.

Në fund të takimit, të njëjtit theksuan se do të kenë koordinim të plotë të aktiviteteve të përbashkëta, me qëllim të zbatimit të planit të punës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, për vitin 2024.



---

### **Udhëheqësja e Departamentit të Përgjithshëm dhe Inspektorët nga Inspektorati i Punës për rajonin e Gjilanit vizituan sektorin e ndërtimtarisë**

**Gjilan, 19 Korrik 2024**

Udhëheqësja e Departamentit të Përgjithshëm nga Prokuroria Themelore në Gjilan, znj. Rozelida Manastiri, së bashku me Inspektorët nga Inspektorati i Punës për rajonin e Gjilanit, në kuadër të planit operativ të përbashkët, kanë vizituar sektorin e ndërtimtarisë në regionin e Gjilanit, komunën e Vitisë dhe Kamenicës.

Arsyeja e këtyre vizitave ka qenë inspektimi lidhur me ndërmarrjen e masave parandaluese në proceset e punës në kuadër të sektorit të ndërtimtarisë, me qëllim që të evitohen rreziqet, të cilat shkaktohen nga ushtrimi i veprimtarisë së punës.



Nga këto vizita, aty ku është gjetur shkelje nga ky sektor janë ndërprerë punimet nga Inspektorët e Punës dhe u njoftuan të njëjtit se gjithmonë duhet të zbatojnë masat mbrojtëse për të shmangur dhe parandaluar rreziqet në punë.

Vizita të tilla dhe takime realizohen vazhdimisht në mes Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe Inspektoratit Qendror të Punës nga rajoni i Gjilanit, me qëllim të koordinimit të ndërmarrjes së veprimeve të përbashkëta.



## **Prokuroria Themelore në Gjilan brenda javës ka ndaluar 18 persona**

**Gjilan, 22 Korrik 2024**

Prokuroria Themelore në Gjilan, brenda javës ka ndaluar tetëmbëdhjetë (18) persona, për shkak të dyshimit se kanë kryer vepra të ndryshme penale dhe në të gjitha rastet ndaj tyre është kërkuar masa e paraburgimit.

Nga Departamenti për Krime të Rënda janë ndaluar dy (2) persona për shkak të dyshimit se kanë kryer veprën penale “Dhuna në familje”.

Ndërsa, nga Departamenti Përgjithshëm janë ndaluar gjashtëmbëdhjetë (16) persona:

- Tetë (8) persona për veprat penale “Lëndimi i lehtë trupor”, “Kanosja” dhe “Sulmi”,
- Një (1) person për veprën penale “Kanosja” ndaj personit zyrtar,
- Tre (3) persona, në dy raste të ndara për veprën penale “Dhuna në familje”,
- Një (1) person për veprën penale “Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë”,
- Dy (2) persona për veprat penale “Kanosja” dhe “Mashtrimi”, si dhe,
- Një (1) person për veprën penale “Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge”.

Vlen të theksohet se gjatë kësaj jave është raportuar edhe një vdekje e dyshimtë në qendrën e paraburgimit në fshatin Pasjak, për të cilën prokurori kujdestar ka dhënë urdhër që trupi i pa jetë të dërgohet për autopsi dhe një rast “Rrëmbimi”, për të cilin në bashkëpunim me policinë janë duke u ndërmarrë veprime hetimore pasi kryerësit ende janë në arrati.

Gjithashtu, janë raportuar edhe raste tjera të cilat janë udhëzuar të trajtohen në procedurë të rregullt dhe se më të theksuara gjatë kësaj jave kanë qenë rastet për vepra penale të narkotikëve dhe kanosjet, të cilat kryesisht dyshohet se kanë ndodhur për shkak të mosmarrëveshjeve pronësore.

---

## **Kërkohet paraburgim ndaj dy personave për ndihmë në kryerjen e veprës penale të rrëmbimit**

**Gjilan, 26 Korrik 2024**

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda, ka parashtruar kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit, ndaj të pandehurve L.C., dhe E.R., për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale “Ndihma në kryerjen e veprës penale të rrëmbimit”, nga neni 33 lidhur me nenin 191 dhe nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Sipas kërkesës, ekziston dyshimi i bazuar se të pandehurit L.C. dhe E.R., më 20 Korrik 2024, në komunën e Gjilanit, me qëllim të përfitimit material, kanë ndihmuar të pandehurin

e tretë, i cili gjendet në arrati, në kryerjen e veprës penale të rrëmbimit, në atë mënyrë që me veturë e kanë transportuar të njëjtin së bashku me të dëmtuarin e mitur nga komuna e Preshevës, nëpër lokacione të ndryshme, edhe pse kanë qenë në dijeni se i mituri ishte rrëmbyer nga i pandehuri i tretë, të cilin e kanë mbajtur të mbyllur në veturë, me qëllim që mos ta dorëzojnë gjersa vëllai i tij të kryente obligimin për transportim të substancës narkotike, për në Beograd.

Të pandehurit L.C., dhe E.R. me urdhër të prokurorit gjenden nën masën e ndalimit 48 orësh.

## **Përmbledhje e punës javore nga Prokuroria Themelore në Gjilan**


**Gjilan, 26 Korrik 2024**

Prokuroria Themelore në Gjilan, gjatë kësaj jave, nga data 22 – 26 Korrik 2024, përmes shkrimitores ka regjistruar dyzet (40) kallëzime penale me gjashtëdhjetenjë (61) persona, për vepra të ndryshme penale.

Gjatë kësaj jave nga Prokuroria Themelore në Gjilan janë proceduar:

- njëzetegjashtë (26) aktakuza,
- shtatë (7) kërkesa për caktimin e masës së paraburgimit,
- njëzettri (23) aktvendime (përfshirë aktvendime për fillimin e hetimeve, për fillimin e procedurës përgatitore, për pushimin e hetimeve, zgjerimin e hetimeve, për hedhje të kallëzimit penal, aktvendime të ekspertëve mjeko – ligjor, aktvendim për ekzaminime),
- tetëmbëdhjetë (18) raporte për mbyllje,
- njëqindnjëzetetë (123) kërkesa të ndryshme drejtuar policisë,
- tetë (8) kërkesa drejtuar QPS-së dhe ZMNV-së,
- dy (2) marrëveshje për pranimin e fajësisë,
- tri (3) raste të zgjidhura përmes procedurës së ndërmjetësimit.

Gjithashtu, nga prokurorët e kësaj prokurorie gjatë kësaj jave janë intervistuar tridhjetedy (32) persona.



## **13 persona të ndaluar brenda javës nga Prokuroria Themelore në Gjilan**

**Gjilan, 29 Korrik 2024**

Prokuroria Themelore në Gjilan, brenda javës ka ndaluar trembëdhjetë (13) persona, për shkak të dyshimit se kanë kryer vepra të ndryshme penale.

- Një (1) person është ndaluar për veprën penale "Sulmi seksual",
- Dy (2) persona për veprën penale "Ndihma në kryerjen e veprës penale të rrëmbimit",
- Një (1) person për veprën penale "Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm",
- Një (1) person për veprën penale "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve",
- Dy (2) persona për veprën penale "Dhuna në familje", si dhe,
- Gjashtë (6) persona në dy raste të ndara për veprën penale "Lëndimi i lehtë trupor", të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Gjatë kujdestarisë, nga Departamenti për Krime të Rënda kanë qenë më të theksuara rastet me të mitur, si kryerës të veprave penale, ndërsa nga Departamenti Përgjithshëm rastet e rrahjeve.

---

## **Kërkohet paraburgim ndaj një personi për sulm ndaj personit zyrtar**

**Gjilan, 01 Gusht 2024**

Prokuroria Themelore në Gjilan, ka parashtruar kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit në Gjykatën Themelore në Gjilan, ndaj të pandehurit Sh.H, për shkak të dyshimit se ka kryer veprën penale "Sulmi ndaj personit zyrtar", të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Sipas kërkesës, ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri Sh.H., më 31 korrik 2024, në Gjilan, me dashje i ka sulmuar pesë zyrtarë policorë, ashtu që derisa të njëjtit ishin në pikë kontroll, duke ushtruar autorizimet e tyre ligjore, afrohet i pandehuri afër tyre, ku fillon të ngacmojë kalimtarët në rrugë dhe pasi i tërhiqet vërejtja nga njëri polic duke i kërkuar që të largohet nga aty, i njëjti fillon t'i ofendojë dhe kanosë me fjalë policët, me ç'rast njëri prej tyre i afrohet dhe e njofton se prej tani është i arrestuar dhe do t'a shoqërojnë në stacion policor, atëherë i pandehuri e shtyen me duar dhe e godet në fytyrë ku si pasojë e lëndimeve ka marrë ndihmë mjekësore dhe po ashtu edhe pasi hynë në veturë e lëndon edhe një polic tjetër dhe i godet në këmbë zyrtarët policorë.

I pandehuri Sh.H., me urdhër të prokurorit gjendet nën masën e ndalimit 48 orësh.



## Përmbledhje e punës javore nga Prokuroria Themelore në Gjilan


Gjilan, 02 Gusht 2024

Prokuroria Themelore në Gjilan, gjatë kësaj jave, nga data 29 korrik – 02 gusht 2024, ka pranuar gjithsej tridhjetegjashtë (36) kallëzime penale.

Gjithashtu gjatë kësaj jave janë proceduar:

- dymbëdhjetë (12) aktakuza,
- tetëmbëdhjetë (18) aktvendime (përfshirë aktvendime për fillimin e hetimeve, për fillimin e procedurës përgatitore, për pushimin e hetimeve, zgjerimin e hetimeve, për hedhje të kallëzimit penal, aktvendime të ekspertëve mjeko – ligjor, aktvendim për ekzaminime),
- pesë (5) kërkesa për caktimin e masës së paraburgimit,
- njëqindnjëzet (120) urgjenca.

Nga prokurorët e kësaj prokurorie gjatë kësaj periudhe kohore janë intervistuar tridhjetetë (33) palë.





## **Prokuroria Themelore në Gjilan brenda javës ka ndaluar 9 persona**

**Gjilan, 05 Gusht 2024**

Prokuroria Themelore në Gjilan, brenda javës, nga data 29 korrik – 04 gusht 2024, ka ndaluar nëntë (9) persona, për shkak të dyshimit se kanë kryer vepra të ndryshme penale.

- Një (1) person është ndaluar për veprën penale ‘‘Sulmi ndaj personit zyrtar’’,
- Një (1) person për veprat penale ‘‘Kanosja’’ dhe ‘‘Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve’’,
- Një (1) person për veprën penale ‘‘Mashtrimi’’,
- Gjashtë (6) persona, në katër raste të ndara për veprën penale ‘‘Dhuna në familje’’.

Prokuroria Themelore në Gjilan, ndaj personave të ndaluar ka parashtruar kërkesat për caktimin e masës së paraburgimit në Gjykatën Themelore në Gjilan.

Gjithashtu, gjatë kësaj jave është raportuar një rast ‘‘Vdekje e dyshimtë’’ në fshatin Shillovë, për të cilën prokurori kujdestar ka dhënë urdhër që trupi i pa jetë të dërgohet për autopsi.

---

## **Prokuroria Themelore në Gjilan gjatë muajit korrik ka ngritur 21 aktakuza për dhunë në familje**

**Gjilan, 06 Gusht 2024**

Prokuroria Themelore në Gjilan, gjatë muajit korrik 2024 ka pranuar njëzetetë (28) kallëzime penale me tridhjetedy (32) persona, për veprën penale ‘‘Dhuna në familje’’, ku nga këto raste të pranuar njëzet (20) viktimat janë të gjinisë femërore, ndërsa, dymbëdhjetë (12) viktimat të gjinisë mashkullore.

Gjatë këtij muaji nga prokurorët e kësaj prokurorie janë ngritur njëzetënjë (21) aktakuza ndaj njëzetëtre (23) personave, për shkak të veprës penale ‘‘Dhuna në familje’’, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe kohore, për dhunë në familje janë ndaluar katërmëdhjetë (14) persona, ndaj të cilëve është kërkuar masa e paraburgimit për sigurimin e prezencës së tyre në procedurë penale.



---

### **Ndalohen 3 persona për vrasje të rëndë në tentativë dhe armëmbajtje pa leje**

**Gjilan, 08 Gusht 2024**

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda, ka ndaluar tre (3) persona, në kohëzgjatje prej 48 orëve, të pandehurit N.H. dhe N.B., për shkak të dyshimit se kanë kryer veprat penale “Vrasja e rëndë në tentativë” dhe “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” dhe të pandehurin A.B., për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Dyshohet se gjatë ditës së sotme, më 08 Gusht 2024, rreth orës 10:07 minuta, në Fshatin e Ri, në komunën e Vitisë, të pandehurit N.B. dhe A.B. janë plagosur gjatë të shtënave me armë zjarri, të cilët për shkak të plagëve të marra kanë kërkuar ndihmë mjekësore fillimisht në Qendrën e Mjekësisë Familjare në fshatin Pozheran, komuna e Vitisë, pastaj janë transferuar në Spitalin Regjional në Gjilan, të cilët për momentin janë jashtë rrezikut për jetë.

Prokuroria Themelore në Gjilan, ndaj të pandehurve brenda afatit ligjor do të kërkojë masën për sigurimin e prezencës së tyre në procedurë penale.



## **Kërkohet paraburgim ndaj 3 personave për vrasje të rëndë në tentativë dhe armëmbajtje pa leje**

**Gjilan, 09 Gusht 2024**

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda, ka parashtruar kërkesë për paraburgim, në Gjykatën Themelore në Gjilan, ndaj të pandehurve N.H., N.B., për shkak të dyshimit se kanë kryer veprat penale “Vrasja e rëndë në tentativë” dhe “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” dhe të pandehurit A.B., për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Sipas kërkesës ekziston dyshimi i bazuar se, i pandehuri N.H., më 08 Gusht 2024, rreth orës 10:07 minuta, në komunën e Vitisë, me dashje ka tentuar ti privoj nga jeta të pandehurit N.B. dhe A.B., në atë mënyrë që për shkak të mosmarrëveshjeve pronësore, sapo i sheh të njëjtit që me djemtë e tyre kishin shkuar në pronën kontestuese, shkon në shtëpinë e tij, merr një armë automatike AK-47 dhe gjuan pandërprerë në drejtim të tyre, me ç’rast të pandehurin N.B. e plagos në këmbë, ndërsa të pandehurin A.B. e plagos në të dy këmbët, duke rrezikuar edhe personat që gjendeshin në të njëjtin vend.

I pandehuri N.B., e kishte armën e zjarrit me vete dhe sapo e sheh që i pandehuri N.H., nga shtëpia e tij kishte dalë me armë, gjuan disa herë në drejtim të tij, por nuk arrin ta qëllojë, duke vënë në rrezik edhe jetën e bashkëshortes së tij, e cila ishte me të.

I pandehuri A.B., dyshohet për armëmbajtje pa leje, e cila është gjetur pas kontrollit në shtëpinë e tij, si dhe të gjitha armët e të pandehurve janë sekuestruar nga ana e zyrtarëve policor.



## **Përmbledhje e punës javore nga Prokuroria Themelore në Gjiilan**

**Gjiilan, 12 Gusht 2024**


Prokuroria Themelore në Gjiilan, brenda javës së fundit, përkatësisht nga data 5 - 11 gusht 2024, ka regjistruar gjithsej tridhjeteshtatë (37) kallëzime penale ndaj pesëdhjetetë (53) personave.

Gjithashtu gjatë kësaj jave janë proceduar:

- dhjetë (10) aktakuza ndaj dymbëdhjetë (12) personave,
- njëzetegjashtë (26) aktvendime (përfshirë aktvendime për fillimin e hetimeve, për fillimin e procedurës përgatitore, për pushimin e hetimeve, zgjerimin e hetimeve, për hedhje të kallëzimit penal, aktvendime të ekspertëve mjeko – ligjor, aktvendim për ekzaminime),
- pesë (5) kërkesa për caktimin e masës së paraburgimit ndaj shtatë (7) personave,
- dyzetegjashtë (46) urgjenca.



Nga prokurorët kujdestarë gjatë kësaj periudhe kohore janë ndaluar shtatë (7) persona, si dhe janë intervistuar njëzetegjashtë (26) palë.



## Koordinatorja e dhunës në familje priti në takim monitorues nga EULEX

**Gjilan, 15 Gusht 2024**

Prokurorja koordinatorë e dhunës në familje, nga Prokuroria Themelore në Gjilan, znj. Rozelida Manastiri, ka pritur në takim monitorues nga EULEX, për dhunë në familje.

Gjatë këtij takimi, ishte e pranishme edhe prokurorja nga Departamenti i Krimeve të Rënda, znj. Leonora Kadriu, e cila paraprakisht ka qenë koordinatorë për këto raste.

Fillimisht u prezantuan raportet e punës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2024, duke theksuar që në këto raste nga prokurorët e kësaj prokurorie ndërmerren të gjitha masat e nevojshme që trajtimi i rasteve të dhunës në familje të bëhet me prioritet dhe të reagohet me urgjencë.

Po ashtu, u diskutuan edhe sfidat me të cilat ballafaqohen prokurorët e kësaj prokurorie lidhur me trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe njoftuan monitoruesit nga EULEX se në të gjitha rastet ku ka bazë ligjore ndalohen personat e dyshuar për dhunë në familje dhe ndaj tyre kërkohet masa për caktimin e paraburgimit.

Në fund të takimit, monitoruesit nga EULEX falënderuan prokuroret nga Prokuroria Themelore në Gjilan për gatishmërinë e pritjes dhe komunikimin e hapur.



---

## **Kërkohet paraburgim ndaj një personi për kultivim dhe posedim të narkotikëve**


**Gjilan, 15 Gusht 2024**

Prokuroria Themelore në Gjilan, ka kërkuar caktimin e masës së paraburgimit nga Gjykata Themelore në Gjilan, ndaj të pandehurit S.J., pasi dyshohet se ka kryer veprat penale “Kultivimi i bimës së hashashit, shkurrese së kokainës ose bimëve të kanabisit” dhe “Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge”, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Sipas kërkesës, ekziston dyshimi i bazuar se, i pandehuri S.J., më 14 Gusht 2024, në komunën e Kamenicës, me dashje, pa autorizim dhe me qëllim të prodhimit të narkotikëve, ka kultivuar bimën e kanabisit, në atë mënyrë që gjatë realizimit të urdhërkontrollit, nga ana e zyrtarëve policor në oborrin e shtëpisë së tij janë gjetur 8 bimë të llojit “Canabis Sativa”, me gjatësi prej 45 cm - 1.30m, në katër vazo të plastikës.

Gjithashtu, tek i pandehuri është gjetur edhe substancë narkotike, e llojit “Marihuanë”, në peshë prej 1.00gr., të cilat janë sekuestruar.

Me këto veprime i njëjti dyshohet të ketë kryer veprat e sipërshtënuara penale.



---

## **Ndalohet një person për aksident me fatalitet**

### **Gjilan, 16 Gusht 2024**

Prokuroria Themelore në Gjilan, ka ndaluar një (1) person, të pandehurin E.O., në kohëzgjatje prej 48 orëve, pasi dyshohet se ka kryer veprën penale “Rrezikimi i trafikut publik”, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Dyshohet se i pandehuri E.O., më 15 Gusht 2024, rreth orës 20:00, në Gjilan, ka shkaktuar aksident trafiku me fatalitet, në atë mënyrë që gjatë drejtimit të automjetit të tij, duke mos respektuar këmbësorin – tani të ndjerin Sh.S., i cili ka qenë duke trupuar rrugën në vendkalimin e këmbësorëve, me pjesën e parë të automjetit e ka goditur të njëjtin, duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore, i cili fillimisht është dërguar për ndihmë mjekësore në Spitalin Regjional në Gjilan, pastaj është transferuar në QKUK, në Prishtinë, ku edhe ka ndërruar jetë.

I pandehuri E.O., gjendet në masën e ndalimit dhe ndaj të njëjtit do të ndërmerren veprimet e mëtejme ligjore.



---

## **Prokuroria Themelore në Gjilan mban takim me ekspertët psikologë për rajonin e Gjilanit**

**Gjilan, 16 Gusht 2024**

Prokuroria Themelore në Gjilan, gjatë ditës së sotme ka mbajtur takim pune me ekspertët psikologë për rajonin e Gjilanit, të cilët janë pritur nga zëvendës Kryeprokurori z. Isuf Sadiku dhe prokurorë të kësaj prokurorie, takim ky i ftuar nga udhëheqësja e Departamentit të Përgjithshëm, znj. Rozelida Manastiri, njëherit edhe koordinatore për rastet e dhunës në familje.

Në këtë takim morën pjesë edhe hetues policor dhe udhëheqësi i Zyrës për Mbrojtjen e Viktimave, për rajonin e Gjilanit, qëllimi i të cilit ishte trajtimi sa më adekuat i viktimave nga dhuna psikologjike.

Fillimisht, zëvendës Kryeprokurori dhe udhëheqësja e Departamentit të Përgjithshëm falënderuan të pranishmit për bashkëpunimin e deritanishëm, duke theksuar se në raste ku është e përdorur dhuna psikologjike të ftohen psikologët, në cilësinë e ekspertëve me qëllim të ofrimit të mbështetjes psikologjike të viktimave, si nga dhuna në familje ashtu edhe të viktimave të rasteve tjera ku kërkohet ekspertimi psikologjik

Gjatë këtij takimi, u nxjerr konkluzion që për rastet specifike, posaçërisht për rastet e dhunës në familje, si pasojë e dhunës psikologjike, gjatë intervistimit të viktimave në stacion policor të marrin pjesë edhe psikologët, të cilët shprehën gatishmërinë e tyre për të



bashkëpunuar me policinë, Zyrën për Mbrojtjen e Viktimave dhe prokurorët e kësaj prokurorie.



## Përmbledhje e punës javore nga Prokuroria Themelore në Gjiilan


Gjiilan, 19 Gusht 2024

Prokuroria Themelore në Gjiilan, brenda javës së fundit, përkatësisht nga data 12 - 18 gusht 2024, ka regjistruar gjithsej dyzet (40) kallëzime penale, ndaj gjashtëdhjetetë (68) personave.

Gjithashtu, gjatë kësaj jave janë proceduar:

- nëntëmbëdhjetë (19) aktakuza, ndaj njëzetedy (22) personave,
- tridhjetegjashtë (36) aktvendime (përfshirë aktvendime për fillimin e hetimeve, për fillimin e procedurës përgatitore, për pushimin e hetimeve, zgjerimin e hetimeve, për hedhje të kallëzimit penal, aktvendime të ekspertëve mjeko – ligjor, aktvendim për ekzaminime),
- gjashtë (6) kërkesa për caktimin e masës së paraburgimit ndaj gjashtë (6) personave,
- katër (4) raste të zgjidhura me marrëveshje dhe ndërmjetësim.

Nga prokurorët kujdestarë gjatë kësaj periudhe kohore janë ndaluar tetë (8) persona, si dhe janë intervistuar tridhjetë (30) palë.



## Pasqyrim javor nga Prokuroria Themelore në Gjilan

Gjilan, 26 Gusht 2024

Prokuroria Themelore në Gjilan, brenda javës së fundit, përkatësisht nga data 19 - 25 Gusht 2024, ka regjistruar gjithsej dyzetënëntë (49) kallëzime penale, ndaj pesëdhjetekatër (54) personave.

Gjithashtu, gjatë kësaj jave janë proceduar:

- tridhjetetri (33) aktakuza, ndaj tridhjetepesë (35) personave,
- shtatëmbëdhjetë (17) aktvendime (përfshirë aktvendime për fillimin e hetimeve, për fillimin e procedurës përgatitore, për pushimin e hetimeve, zgjerimin e hetimeve, për hedhje të kallëzimit penal, aktvendime të ekspertëve mjeko – ligjor, aktvendim për ekzaminime),
- gjashtë (6) kërkesa për caktimin e masës së paraburgimit, ndaj gjashtë (6) personave,
- dy (2) raste të zgjidhura përmes procedurës së ndërmjetësimit.

Po ashtu, nga prokurorët kujdestarë gjatë kësaj periudhe kohore janë ndaluar gjashtë (6) persona, si dhe nga prokurorët e kësaj prokurorie janë intervistuar dyzetetri (43) palë.

**Prokuroria  
Themelore  
Gjilan**

Pasqyrim javor nga Prokuroria  
Themelore në Gjilan

19 - 25 Gusht 2024

- 49 kallëzime penale të regjistruara
- 33 aktakuza
- 17 aktvendime
- 6 kërkesa për paraburgim
- 2 ndërmjetësime
- 6 persona të ndaluar
- 43 palë të intervistuar



## Ndalohe t një person për kultivim të narkotikëve

**Gjilan, 30 Gusht 2024**

Prokuroria Themelore në Gjilan, me urdhër të prokurorit kujdestar të Departamentit të Krimeve të Rënda, ka ndaluar të dyshuarin E.A., në kohëzgjatje prej 48 orëve, për shkak të dyshimit se ka kryer veprën penale “Kultivimi i bimës së hashashit, shkurre së kokainës ose bimëve të kanabisit”, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Dyshohet se i lartshënuari, në afërsi të vendbanimit të tij, në komunën e Vitisë, me dashje, pa autorizim dhe me qëllim të prodhimit të narkotikëve, ka kultivuar bimën e kanabisit, ashtu që më datë 29 Gusht 2024, gjatë realizimit të urdhërkontrollit nga ana e zyrtarëve policor, në vendin e ngjarjes janë gjetur 9 bimë “Canabis Sativa”, me gjatësi prej 80 – 210 cm, të cilat janë asgjësuar.

I pandehuri E.A., gjendet në masën e ndalimit dhe ndaj të njëjtit do të ndërmerren veprimet e mëtejme ligjore.





## Kërkohet paraburgim ndaj një personi për rrezikim të trafikut publik

Gjilan, 30 Gusht 2024

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti Përgjithshëm, ka kërkuar caktimin e masës së paraburgimit nga Gjykata Themelore në Gjilan, në afat prej 30 ditësh, ndaj të pandehurit Z.D., për shkak të dyshimit se ka kryer veprën penale ‘‘Rrezikimi i trafikut publik’’, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Sipas kërkesës, ekziston dyshimi i bazuar se, i pandehuri Z.D., më 29 Gusht 2024, rreth orës 15:10, në rrugën Gjilan – Preshevë, më saktësisht në fshatin Velekincë, nga pakujdesia, ka rrezikuar trafikun publik, ashtu që duke drejtuar automjetin, ka vepruar në kundërshtim me dispozitën ligjore të nenit 50, të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor, në atë mënyrë që, duke mos e përshtatur shpejtësinë e automjetit të tij dhe duke mos pasur kujdesin e duhur për këmbësorë, me pjesën e parë të automjetit e godet këmbësorin, tani të ndjerin R.Xh., i cili në momentin kritik po e kalonte rrugën, me ç’rast shkakton aksident me lëndime të natyrës vdekjeprurëse, i cili për shkak të lëndimeve të pësuarra dërgohet për ndihmë mjekësore në Emergjencën e Spitalit Regjional në Gjilan dhe aty ndërrohet jetë.

I njëjti me urdhër të prokurorit kujdestar gjendet nën masën e ndalimit 48 orësh, për veprën e sipërpëshënuar penale.



## **Ndalohet një person për falsifikim të dokumentit**

**Gjilan, 12 Shtator 2024**

Prokuroria Themelore në Gjilan, në bashkëpunim me Njësinë Rajonale për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit, në Gjilan, ka ndaluar të dyshuarin F.N., në kohëzgjatje prej 48 orëve, për shkak të dyshimit se ka kryer veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, nga neni 390 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Ekziston dyshimi, se i dyshuari F.N., ka siguruar dhe ka përdoruar patentë shofer të Republikës së Kosovës, i cili dyshohet se është falsifikuar dhe nuk ka kaluar nëpër procedurat e rregullta ligjore për lëshimin e tij nga autoritetet përkatëse, të cilin e kishte siguruar nga një person i panjohur, duke paguar shumën e të hollave prej 400 euro.

I njëjti me urdhër të prokurorit gjendet në masën e ndalimit 48 orësh dhe brenda afatit ligjor ndaj tij do të vendoset rreth masës për sigurimin e tij në procedurë penale.



## Përmbledhje e punës javore nga Prokuroria Themelore në Gjilan

**Gjilan, 16 Shtator 2024**

Prokuroria Themelore në Gjilan, gjatë javës së fundit, përkatësisht nga data 9 – 15 Shtator 2024, ka pranuar gjithsej tetëdhjetetë (88) kallëzime penale.

Gjithashtu gjatë kësaj jave janë proceduar:

- gjashtëdhjetenjë (61) aktakuza ndaj gjashtëdhjetegjashtë (66) personave,
- pesëdhjetë (50) aktvendime (përfshirë aktvendime për fillimin e hetimeve, për fillimin e procedurës përgatitore, për pushimin e hetimeve, zgjerimin e hetimeve, për hedhje të kallëzimit penal, aktvendime të ekspertëve mjeko – ligjor, aktvendim për ekzaminime),
- shtatë (7) ankesa,
- gjashtë (6) persona të ndaluar,
- gjashtë (6) kërkesa për caktimin e masës së paraburgimit ndaj gjashtë (6) personave.

Nga prokurorët e kësaj prokurorie gjatë kësaj periudhe kohore janë intervistuar tridhjetedy (32) persona.



## Aktakuzë ndaj një personi për kultivim të narkotikëve

**Gjilan, 18 Shtator 2024**

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzë ndaj të pandehurit E.A., për shkak të veprës penale ‘Kultivimi i bimës së hashashit, shkurrese së kokainës ose bimëve të kanabisit’, nga neni 272 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Sipas aktakuzës, në komunën e Vitisë, më datë 29 Gusht 2024, rreth orës 10:30 minuta, është konstatuar se i pandehuri E.A, pa autorizim, ka kultivuar bimën e kanabisit, ashtu që në afërsi të vendbanimit të tij, ka mbjellë nëntë (9) bimë narkotike ‘Canabis Sativa’, me gjatësi prej 80 – 210 cm, të cilat i ka kultivuar me qëllim të prodhimit të substancave narkotike.

Prokuroria Themelore në Gjilan, i ka propozuar gjykatës që i pandehuri të shpallet fajtor për veprën penale, e cila i vihet në barrë.





## Kryeprokurori Kadriu priti në takim Drejtorin e Policisë Rajonale të Gjilanit

Gjilan, 19 Shtator 2024

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan, z. Arben Kadriu, ka pritur në takim pune Drejtorin e Policisë Rajonale të Gjilanit, z. Agron Rukiqi, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, ku në këtë takim ishin prezent edhe prokurorët nga Departamenti për Krime të Rënda dhe Departamenti Përgjithshëm i kësaj prokurorie.

Gjatë këtij takimi, temë diskutimi ishte koordinimi dhe bashkëpunimi në ndërmarrjen e veprimeve të përbashkëta, me ç'rast Kryeprokurori Kadriu dhe Drejtori Rukiqi vlerësuan bashkëpunimin e deritanishëm mes këtyre dy institucioneve.

Gjithashtu, u diskutua sa i përket komunikimit mes institucioneve gjatë kujdestarive, pastaj për ndërmarrjen e veprimeve gjatë realizimit të urdhërkontrolleve.

Nga Kryeprokurori u kërkuar që të trajtohen me prioritet të gjitha rastet kriminale, e posaçërisht rastet e dhunës në familje dhe kërkoi që të ndërmerren të gjitha veprimet që në fazën fillestare të paraqitjes së tyre.

Nga Drejtori Rukiqi, u theksua se në krahasim me gjashtëmujorin e parë të vitit të kaluar, në këtë gjashtëmujor ka rënie të rasteve të lëndimeve të rënda trupore, vjedhjeve, grabitjeve, aksidenteve me fatalitet.

Takimi rezultoi me gatishmërinë për bashkëpunim të mëtutjeshëm dhe vazhdimin e takimeve të rregullta mujore.







## Përmbledhje e punës javore nga Prokuroria Themelore në Gjilan

Gjilan, 23 Shtator 2024

Prokuroria Themelore në Gjilan, gjatë javës së fundit, përkatësisht nga data 16 - 22 Shtator 2024, ka pranuar gjithsej njëzetënëntë (29) kallëzime penale, ndaj dyzetetre (43) personave.

Gjithashtu gjatë kësaj jave janë proceduar:

- tridhjetedy (32) aktakuza, ndaj tridhjetepesë (35) personave,
- dyzetenjë (41) aktvendime (përfshirë aktvendime për fillimin e hetimeve, për fillimin e procedurës përgatitore, për pushimin e hetimeve, zgjerimin e hetimeve, për hedhje të kallëzimit penal, aktvendime të ekspertëve mjeko – ligjor, aktvendim për ekzaminime),
- tetë (8) ankesa,
- nëntë (9) persona të ndaluar,
- nëntë (9) kërkesa për caktimin e masës së paraburgimit ndaj nëntë (9) personave,
- njëzetedy (22) urgjenca.

Nga prokurorët e kësaj prokurorie gjatë kësaj periudhe kohore janë intervistuar dyzetenjë (41) persona, si dhe gjatë kujdestarisë më të theksuara kanë qenë rastet për falsifikim të parave.



## Përmbledhje e punës javore nga Prokuroria Themelore në Gjilan

Gjilan, 30 Shtator 2024

Prokuroria Themelore në Gjilan, gjatë javës së fundit, përkatësisht nga data 23 - 29 Shtator 2024, ka regjistruar gjithsej tetëmbëdhjetë (18) kallëzime penale, ndaj njëzetënjë (21) personave.

Gjithashtu gjatë kësaj jave janë proceduar:

- gjashtëdhjetënjë (61) aktakuza, ndaj gjashtëdhjetëgjashtë (66) personave,
- dyzetetri (43) aktvendime (përfshirë aktvendime për fillimin e hetimeve, për fillimin e procedurës përgatitore, për pushimin e hetimeve, zgjerimin e hetimeve, për hedhje të kallëzimit penal, aktvendime të ekspertëve mjeko – ligjor, aktvendim për ekzaminime),
- nëntë (9) ankesa,
- pesëmbëdhjetë (15) kërkesa për shitje të aseteve,
- dy (2) persona të ndaluar,
- dy (2) kërkesa për caktimin e masës së paraburgimit ndaj dy (2) personave.

Nga prokurorët e kësaj prokurorie gjatë kësaj periudhe kohore janë intervistuar tridhjetë (30) persona.

